



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

**TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori IV 2019**



Data e Publikimit: 11.02.2020

## Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME .....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE .....	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare .....	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare .....	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar .....	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	9

## I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e katërt të vitit 2019 dhe krahasimet me tremujorin e tretë të vitit 2019 dhe me tremujorin e katërt të vitit 2018, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e katërt të vitit 2019 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (17 subjekte):**

1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
2. Albanian Courier sh.p.k (A.C) 24.01.2020;
3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
4. DHL International (Albania) sh.p.k;
5. RAD MAIL sh.p.k, çregjistruar me datë 21.01.2020;
6. Sky Net Logistic sh.p.k, çregjistruar me datë 24.12.2019;
7. TNT Express Albania sh.p.k;
8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
9. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
10. Youth Albania Professional Services (YAPS);
11. Fast-Delivery sh.p.k, çregjistruar me datë 22.11.2019;
12. E-KOMPLET sh.p.k;
13. COEX shpk;
14. Albanian Parcel Distribution shpk;
15. Speed Couriers Albania (Albi Shkurta – person fizik);
16. INTEX COURIER sh.p.k;
17. TURBOO ALBANIA sh.p.k;
18. PANORAMA GROUP sha

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019 rezultojnë 7,323,652 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

**Tabela 1.1-** Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e katërt 2019 dhe krahasimi me tremujorin e tretë 2019 dhe me tremujorin e katërt 2018.


Shërbime postare të ofruara	T4_2018	T1_2019	T2_2019	T3_2019	T4_2019	Ndryshim T4_2019/ T3_2019	Ndryshim T4_2019/ T4_2018
<b>Posta Shqiptare sh.a</b>							
<b>1 Shërbim Universal Postar</b>							
1.1 Postë brenda vendit	4,246,184	4,821,716	5,524,563	4,238,676	5,032,877	18.7%	19%
1.2 Postë ndërkombëtare	234,923	413,819	440,588	3,388,734	304,059	-91.0%	29%
<b>1.3 Totali 1.1+1.2</b>	<b>4,481,107</b>	<b>5,235,535</b>	<b>5,965,151</b>	<b>7,627,410</b>	<b>5,336,936</b>	<b>-30.0%</b>	<b>19%</b>
<b>2 Shërbim joniversal postar</b>							
2.1 Postë brenda vendit	896,597	266,060	126,798	131,101	962,635	634.3%	7%
2.2 Postë ndërkombëtare	472	262	5,310	314	934	197.5%	98%
<b>2.3 Totali 2.1+2.2</b>	<b>897,069</b>	<b>266,322</b>	<b>132,108</b>	<b>131,415</b>	<b>963,569</b>	<b>633.2%</b>	<b>7%</b>
<b>3 Shërbim ekspres</b>							
3.1 Ekspres brenda vendit	177,621	175,231	172,580	176,999	123,039	-30.5%	-31%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	5,434	6,400	6,448	6,223	49,877	701.5%	818%
<b>3.3 Totali 3.1+3.2</b>	<b>183,055</b>	<b>181,631</b>	<b>179,028</b>	<b>183,222</b>	<b>172,916</b>	<b>-5.6%</b>	<b>-6%</b>
<b>Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare</b>							
<b>4 Shërbim JoUniversal Postar</b>							
4.1 Postë brenda vendit	117,747	147,651	155,986	186,595	165,591	-11.3%	40.6%
4.2 Postë ndërkombëtare	8,653	10,702	10,515	9,771	10,953	12.1%	26.6%
<b>4.3 Totali 4.1+4.2</b>	<b>126,400</b>	<b>158,353</b>	<b>166,501</b>	<b>196,366</b>	<b>176,544</b>	<b>-10.1%</b>	<b>39.7%</b>
<b>5 Shërbim ekspres</b>							
5.1 Ekspres brenda vendit	414,844	424,681	465,936	510,385	608,791	19.3%	46.8%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	61,763	58,899	67,334	78,235	64,896	-17.0%	5.1%
<b>5.3 Totali 5.1+5.2</b>	<b>476,607</b>	<b>483,580</b>	<b>533,270</b>	<b>588,620</b>	<b>673,687</b>	<b>14.5%</b>	<b>41.4%</b>
<b>6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>	<b>6,164,238</b>	<b>6,325,421</b>	<b>6,976,058</b>	<b>8,727,033</b>	<b>7,323,652</b>	<b>-16.1%</b>	<b>18.8%</b>

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T4 2019

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	6,473,421	88%
<i>Of. e tjerë</i>	850,231	12%
<i>Totali</i>	7,323,652	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e katërt të vitit 2019 Posta Shqiptare zë rreth **88%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **12%**.

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujorë




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e katërt 2019 ka realizuar 6,473,421 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 1,468,626 objekte postare më pak se tremujori i tretë 2019, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e katërt 2019 kanë realizuar 65,245 objekte postare më shumë se në tremujorin e tretë të vitit 2019.

**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T4-2019

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
5,336,936	1,140,113	846,603	7,323,652
72.9%	15.6%	11.6%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 72.9% ose 5,336,936 objekte postare, ndjekur nga shërbimi jo universal me 15.6% ose 1,140,113 objekte postare. Shërbimi ekspres zë 11.6% ose 846,603 objekte postare.

**Grafiku 1.2** Ecuria në 3-mujorë sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhet në nivelet rreth 73% për tremujorin e katërt të vitit 2019. Nga krahasimi i periudhës T4-2019 me periudhën T3-2019, vërehet një rënie e numrit të shërbimeve postare në masën 1,403,381 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të katërt të vitit 2019 me tremujorin e katërt të vitit 2018 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 1,159,414 shërbime.


## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T4-2019

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	5,032,877
Postë ndërkombëtare	304,059
<b>Totali</b>	<b>5,336,936</b>

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të katërt 2019, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,336,936 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 5,032,877 ose 94%, dhe Postë ndërkombëtare 304,059 objekte, ose 6%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 453,7245 shërbime për objekte të thjeshta dhe 495,632 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 273,168 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 30,891 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujë



### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
Shërbim universal postar	5,336,936	82%
Shërbim jo universal postar	963,569	15%
Shërbim ekspres	172,916	3%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 5,336,936 objekte postare ose 82%, i ndjekur nga shërbimi jo universal me 963,569 objekte postare ose 15%, dhe shërbimi ekspres me 172,916 objekte postare ose 3%.

**Grafiku 1.4:** Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujorë



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2019 dhe 3-mujorit të fundit të vitit 2018, nga ku vihet re një rënie e ndjeshme për shërbimin universal dhe rritje për shërbimin jo universal postar, krahasuar kjo me tremujorin e mëparshëm.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.


**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Sh	963,569	85%
Of. e tjerë	176,544	15%
<b>Totali</b>	<b>1,140,113</b>	<b>100%</b>

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i ka Posta Shqiptare me 963,569 objekte postare ose 85% të tregut, kundrejt Ofruesve të tjerë me 176,544 objekte postare ose 15%.



**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujorë



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e katërt 2019 krahasuar me tremujorin e tretë 2019 janë rritur për Postën Shqiptare me 832,154 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë ulur me 19,822 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rritje e ndjeshme e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim duke arritur në të njëjtat nivele me të njëjtën periudhë të vitit 2018 (nga rreth 88% që zinte në tremujorin e katërt të vitit 2018, pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ka arritur në rreth 85%).

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019 përbëhej nga 1,128,226 objekte brenda vendit dhe 11,887 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


### 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të katërt të vitit 2019, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2018, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e katërt 2019.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Shqiptare	172,916	20%
Of. e tjerë	673,687	80%
<b>Totali T4-2019</b>	<b>846,603</b>	<b>100%</b>

**Grafik 1.6:** Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria ne 3-mujore



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2019 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2018, sikundër vërehet rritje në shërbimet postare ekspres për tremujorin e katërt të vitit 2019 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T3–2019). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për Postën Shqiptare, ku nga rreth 28% të tregut për këtë tregues në tremujorin e katërt të vitit 2018, pjesa e tregut të Postës Shqiptare në tremujorin e katërt të vitit 2019 ka arritur në rreth 20%, përkundrajt rreth 80% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 731,830 objekte postare ose 86%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 114,773 objekte postare ose 14%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 49,138 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e vogël se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 65,635 objekte.